



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 1774/prot.

Vlorë, më 15.11.2022

Të publikohet në Web

VENDIM

Nr. 45, datë 26.10.2022



PËR

**ÇELJEN E PROCEDURËS PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË MBESHTUR VAKANT NË
KOMISIONIN INSTITUCIONAL ZGJEDHOR NË UV**

Në mbështetje të nenit 38 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 19 të Statutit të UV-së, nenit 6, pika 1 të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë", si dhe për shkak të mos patjes kandidatë studentë gjatë fazës së kaluar të hapjes së procedurës së vetëkandidimit për anëtar të KIZ miratuar me vendim SA nr. 38, datë 26.10.2022, Senati Akademik në mbledhjen e datës 14.11.2022

VENDOSI:

1. Të miratojë rihapjen e procedurës për vetëkandidim për anëtar të komisionit institucional zgjedhor (KIZ) në UV, për plotësimin e vendit vakant pas dorëheqjes së anëtarit përfaqësues i studentëve në KIZ.
2. Periudha kohore e pranimit të vetëkandidimeve zgjat nga data 15.11.2022 deri më 22.11.2022.
3. Vetëkandidimi dorëzohet në Zyrën e Protokollit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë dhe do të administrohen nga sekretara e Senatit Akademik.
4. Ngarkohet Drejtoria e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore për shpallje në faqen web të vendimit dhe bërjen e njoftimeve përkatëse.
5. Një kopje e këtij vendimi i bëhet me dije Komisionin Institucional Zgjedhor në UV.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI

